



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 142, datë 02.12.2019

PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË ZOTIT ARTUR MALAJ, NË VENDIN
VAKANT PËR INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË, SHPALLUR NGA
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI NË DATËN 01.03.2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Margarita Buhali	- Anëtare/Relatore
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Fatri Islamaj	- Anëtar
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dula**,

Me praninë e Avokates së Popullit, **zonjës Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **zotit Bledar Dervishaj**, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës,

në mbledhjen e datës 02.12.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATI PËR INSPEKTOR
I LARTË I DREJTËSISË:**

Zoti Artur Malaj

OBJEKTI:

Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të z. Artur Malaj, në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur në datën 01.03.2019.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjo i relatimin e anëtares së Këshillit, **zonjës Margarita Buhali**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, **zoti Erinda Ballanca**, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 199 dhe 229 të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 01.03.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka filluar shqyrtimin e aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 199 të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, është edhe zoti Artur Malaj.

4. Në zbatim të nenit 147/d dhe 149/d të Kushtetutës dhe të nenit 199, 229, 235 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja Margarita Buhali.

7. Zoti Artur Malaj, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Artur Malaj, gjendet e administruar në dosjes e kandidimit.

8. Në datën 08.04.2019, kandidati Artur Malaj është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen kandidimit.

9. Në datën 09.04.2019, kandidati Artur Malaj ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

10. Në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisionin i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 62 datë 03.08.2018 ka konfirmuar në detyrë zotin Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit.

11. Duke u bazuar në përfundimet dhe vendimin e sipërcituar të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit lidhur me verifikimin e pasurisë dhe pjesërisht të integritetit të kandidatit Artur Malaj, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në përfundim të procedurave të tjera të verifikimit për elementë që nuk janë në objektin e verifikimit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe të plotësimit të kushteve të tjera ligjore të kandidimit, me vendimin nr. 69, datë 24.07.2019 ka vendosur:

“1. Lejimin e kandidimit të kandidatit Artur Malaj, në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019”.

12. Në kohën e dhënies së këtij vendimi , Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka mbajtur në konsideratë faktin se kandidati ishte konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe deri në kohën e verifikimit të kushteve të kandidimit nuk kishte një vendim të ndryshëm nga Komisioni i Posaçëm i Apelit ndaj tij. Në frymën e Kushtetutës dhe të nenit 283/1 të ligjit nr.115/2016 nuk parashikohet pezullim i procesit të kandidimit për kandidatët për Inspektor të Lartë të Drejtësisë në rastet kur ndaj vendimit të tyre konfirmues në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit është bërë ankim. Përkundrazi në nenin 283/1 të ligjit nr.115/2016 është parashikuar, që magjistratët të cilët shprehin interes për kandidimin në pozicionin e Inspektorit të lartë të Drejtësisë depozitojnë dokumentacionin në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe rivlerësimi i tyre bëhet me përparësi. Dispozita nuk përcakton nëse ky rivlerësim për efekt kandidimi duhet të ketë përfunduar vetëm në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit apo me vendim të formës së prerë. Duke mbajtur në konsideratë shpejtësinë dhe afatet e shkurtra që parashikohen për procesin e kandidimit për Inspektor të Lartë të Drejtësisë sipas neneve 235-240 të ligjit nr.115/2016 dhe parashikimet analoge për kandidimet për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe atij të Prokurorisë sipas neneve 276/3 dhe 279/4 të ligjit nr.115/2016, ku kërkohet si kusht për kandidim vendimi i konfirmimit në detyrë të komisionit të pavarur të kualifikimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vendosi të lejojë kandidimin e z.Artur Malaj me vendimin nr.69 dt.24.07.2019.

13. Pas dhënies së vendimit nr. 69 datë 24.07.2019 të këtij Këshilli, Kolegji i Posaçëm i Apelit, me shkresën nr. 1040/9 prot, datë 24.10.2019, i ka përcjellë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, vendimin nr. 27, datë 24.10.2019, me të cilin është vendosur: Ndryshimi i vendimit nr. 62, datë 03.08.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimi nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artur Malaj.

14. Në zbatim të ligjit nr. 115/2016, si dhe të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, anëtarja e Këshillit relatore për ndjekjen e procedurave për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, ka njoftuar Këshillin lidhur me këtë gjetje të konstatuar për kandidatin Artur Malaj, duke përgatitur dhe dërguar për shqyrtim relacionin dhe projektaktin përkatës mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kësaj kandidature.

15. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 02.12.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt përfundimin e procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës së zotit Artur Malaj, për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, për shkak të vendimit nr. 27, datë 24.10.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me të cilin është vendosur: Ndryshimin e vendimit nr. 62, datë 03.08.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artur Malaj.

16. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatorja, i është njoftuar kandidatit Artur Malaj.

17. I njëjti njoftim, së bashku me materialet e çështjes i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

18. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 02.12.2019 dhe rendin e ditës janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

19. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

20. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Artur Malaj.

21. Në thelb, Avokati i Popullit parashtroi se: Kam vetëm për të diskutuar dhe një herë atë që do na ndodhi edhe herë të tjera i njëjti problem dhe do bjerë reputacioni të themi apo ideja që ky Këshill kalon dhe propozon individë që se kanë përfunduar plotësisht procesin e vetingut. Nuk ka qenë qëllimi i këtij Këshilli por rikthej në vëmendje faktin që ngjarje të tilla, siç ndodhi edhe në rastin e zotit Muçi apo mund të na ndodhin nëse ne do të vijojmë me këtë procedurë, nuk varen nga ne. Por e vërteta është që do të duhej që nëse keni gjyqtar apo prokuror të cilët janë në proces rivlerësimi kalimtar të kërkohet shqyrtimi me prioritet. Kjo është një kërkesë që duhet bërë. Organet e zbatimit të reformës në drejtësi funksionojnë të gjitha së bashku si një e tërë për ta çuar reformën përpara Nëse ky është rasti, kujtohem se ju e keni referuar disa herë çështjen dhe do të ishte mirë që në vendimmarrjet tona, në pjesën

përshkruese ta shënonim edhe këtë gjë, për të treguar që Këshilli nuk ka mënyrë tjetër për t'ja paraqitur publikut veprimtarinë që ka kryer përveçse në pjesët arsyetuese të vendimeve për të treguar që ka bërë maksimumin. Kjo në mënyrë që të mos çënohet ajo që është besimi i publikut tek Këshilli dhe reforma në drejtësi.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

22. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme, bazuar në relacionin dhe aktet e dërguara nga anëtari i Këshillit relator i caktuar për ndjekjen e procedurave për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë të shpallur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndërprerjen e procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatit Artur Malaj dhe ndalimin e kandidimit.

23. Në pikën 3 të nenit 147/d të Kushtetutës, parashikohet se:

“3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ai nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.”

24. Në pikën 1 të nenit 199 të Ligjit nr. 115/2016 parashikohet se:

“1. Inspektor i Lartë i Drejtësisë mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që në momentin e kandidimit përmbush këto kushte:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të ketë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;

c) ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist;

ç) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale;

d) nuk është pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit;

dh) nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;

e) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

ë) nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.”

25. Në pikën 1 të nenit 201 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikohet se:

“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga Kuvendi nga radhët e kandidatëve të përzgjedhur dhe të renditur nga Këshilli për Emërimet në Drejtësi”.

26. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 199 dhe 229 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në përfundimit të afatit të caktuar të shpalljes “Për hapjen e Procedurës së Aplikimit në Pozicionin Vakant Inspektor i Lartë i

Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi ka administruar dokumentacionin e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë pozicion, ka filluar në datën 05.04.2019 procedurën e verifikimit të kandidaturave për plotësimin e kushteve dhe kritereve të kandidimit që parashikohen nga Kushtetuta dhe ligji.

27. Kushtet e kandidimit për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, sikurse janë edhe ato të përmendura në pikat 21 dhe 22 më sipër, duhet të plotësohen secili dhe të gjithë së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për tu përzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emërtesës.

28. Për rrjedhojë, nëse kandidati për Inspektor i Lartë i Drejtësisë nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të vënë në bisedim dhe për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

29. Kandidati Artur Malaj është gjyqtar. Për rrjedhojë, është njëherazi edhe subjekt i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Prandaj, në zbatim të nenit 179/b dhe Aneksit “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve” të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për sa i përket verifikimit dhe kontrollit të pasurisë dhe të figurës, merr parasysh dhe mbështetet, sipas rastit, në konkluzionet e realizuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit.

30. Kolegji i Posaçëm i Apelit me shkresën nr. 1040/9 prot, datë 24.10.2019, i ka përcjellë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vendimin nr. 27, datë 24.10.2019 me të cilin është vendosur: Ndryshimi i vendimit nr. 62, datë 03.08.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimi nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artur Malaj.

31. Në shkronjat “d” të pikës 1 të nenit 199 të Ligjit nr. 115/2016, të sipërcituar përcaktohet si kusht ligjor për lejimin e kandidimit që kandidati *të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.*

32. Vendimet e organeve të rivlerësimit kalimtar për shkarkimin nga detyra të magistratëve, përbëjnë njëkohësisht masë ekstreme disiplinore ndaj tyre. Ndërkohë, në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 199 të Ligjit nr. 115/2016 kjo masë disiplinore përbën shkak për ndalimin e kandidimit.

33. Në aktin nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në pikat 104 dhe 111 parashikohet se:

“104. Kandidatët magistratë dhe subjektet e tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, për të cilët nuk është dhënë vendim nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të integritetit nga Këshilli. Vendimi i Këshillit, për urdhërimin e lejimit ose të ndalimit të kandidimit sipas neneve 235 dhe 236 të ligjit nr. 115/2016 për këta kandidatë, do të mbështetet në vendimin e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.”

“111. Kandidatët magistratë dhe subjektet e tjerë që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të

Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim, nuk lejohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016.”.

34. Sikurse është arsyetuar më sipër, rezulton se kanë ndryshuar rrethanat që u morën në konsideratë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në momentin e lejimit të kandidimit të kandidatit Artur Malaj me vendimin nr. 69, datë 24.07.2019, për shkak se aktualisht kandidati është i shkarkuar nga detyra e tij si gjyqtar. Kjo rrethanë përbën shkak për ndalimin e kandidimit të tij dhe për pasojë sjell shfuqizimin e vendimit të KED nr. 69, datë 24.07.2019 për lejimin e kandidimit sipas nenit 113/1 të K.Pr.Administrative i cili parashikon se: *Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.*

35. Fakti se KED ka lejuar kandidimin nisur nga kushtet që kanë ekzistuar në momentin dhënies së vendimit të tij nr.69/2019, nuk e pengon Këshillin e Emërimeve në Drejtësi të shfuqizojë këtë vendim në një moment të dytë për rrethana të dala rishtazi, përderisa ende nuk ka përfunduar procesi i verifikimit të kushteve të kandidimit, vlerësimit dhe pikëzimit të të gjithë kandidatëve. Procesi i vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë nuk ka filluar pasi Këshilli i Emërimeve në Drejtësi e ka rishpallur procedurën e plotësimit të kandidaturave për këtë vend vakant në datën 09.09.2019 për shkak të rënies së numrit të kandidatëve nën atë minimal 5 të përcaktuar në nenin 147/d pika 4 të Kushtetutës. Në kërë rast, ky vendim i Këshillit për shfuqizimin e vendimit të tij nr.69/2019 për lejimin e kandidimit të kandidatit Artur Malaj merret pikërisht në fazën e verifikimit të kushteve të kandidimit edhe për kandidatët e tjerë të përfshirë rishtazi në garë.

36. Llojet e vendimeve që merren nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi janë të parashikuar në ligjin nr.115/2016 dhe konsistojnë në lejimin ose ndalimin e kandidimit për rastet e parashikuara nga neni 235, 236 dhe 237 të ligjit dhe më pas në ato për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të lejuar për kandidim. Në kushtet kur për kandidatin Artur Malaj kanë dalë rishtazi rrethana që përbëjnë shkak për ndalimin e kandidimit, procesi i vlerësimit dhe pikëzimit të këtij kandidati nuk mund të vazhdojë pikërisht sepse është në kushtet e ndalimit të kandidimit. Pra ndërprerja e procesit të kandidimit është pasojë e kushteve që pengojnë kandidimin. Prandaj del e domosdoshme që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi të disponojë për shfuqizimin e vendimit të mëparshëm për lejimin e kandidimit me nr.69/2019, si organi publik që ka në kompetencë të nxjerr aktin dhe të vendosë ndalimin e kandidimit.

37. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit dhe të vlerësimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të ndërpresë procedurën e vlerësimit, të shfuqizojë vendimin e mëparshëm për lejimin e kandidimit dhe të vendosë ndalimin e kandidimit të kandidatit Artur Malaj në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 01.03.2019, rishpallur për plotësim me kandidatura të tjera në datën 09.09.2019.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 229 dhe 235 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “b” të pikës 50, 51 dhe 77 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Ndërprerjen e procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës së zotit Artur Malaj për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, rishpallur për plotësim me kandidatura të tjera në datën 09.09.2019.
2. Shfuqizimin e vendimit nr.69, datë 24.07.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për lejimin e kandidimit të kandidatit Artur Malaj, në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019
3. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Artur Malaj në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, rishpallur për plotësim me kandidatura të tjera në datën 09.09.2019.
4. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Artur Malaj.
5. Kandidati Artur Malaj ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
6. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI



Mendim Pakice i Anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Vitore Tusha dhe Eriol Roshi.

Ne anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësit Vitore Tusha dhe Eriol Roshi jemi pjesërisht kundër disponimit të bërë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në vendimin nr. 142, datë 02.12.2019, datë lidhur me kandidatin për vendin e Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, zotin Artur Malaj.

Më konkretisht, me vendimin nr.142, datë, 02.12.2019 KED ka vendosur: “1. Ndërprerjen e procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës së zotit Artur Malaj për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, rishpallur për plotësim me kandidatura të tjera në datën 09.09.2019.

2. Shfuqizimin e vendimit nr.69, datë 24.07.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “ *Për lejimin e kandidimit të kandidatit Artur Malaj, në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019*

3. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Artur Malaj në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, rishpallur për plotësim me kandidatura të tjera në datën 09.09.2019.

4. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Artur Malaj.

5. Kandidati Artur Malaj ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

6. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi”.

Ne anëtarët në pakicë jemi dakort me pjesën përshkruese të të gjithë ecurisë së procesit që përshkruhet në vendim si dhe me disponimin që për kandidatin Artur Malaj duhet të ndërpritet procedura e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së tij dhe përcjelljes së listës përkatëse në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, për shkak të vendimit nr. 27, datë 24.10.2019 të Kolegjit të Pavarur të Kualifikimit me të cilin është vendosur: Ndryshimi i vendimit nr. 62, datë 03.08.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimi nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artur Malaj, pra se ky kandidat nuk mund të përfshihet në listën që i propozohet Kuvendit për ILD.

Nga ana tjetër, jemi kundër formulimit juridik të shumicës për nevojën e ndërprerjes së procedurës vlerësimit pikëzimit etj., me anë të shfuqizimit të vendimit nr. 69, datë 24.07.2019 të KED-së lidhur me lejimin e kandidimit të zotit Artur Malaj dhe ndalimit të kandidimit të tij në

vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, rishpallur për plotësim me kandidatura të tjera në datën 09.09.2019.

Ky qëndrim i yni bazohet në interpretimin që i bëhet vendimit që merr KED në fazën e parë të procesit të shqyrtimit të kandidaturave si për Gjykatën Kushtetuese ashtu edhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Për të mos u zgjatur , në fazën e parë të verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit, Këshilli ka vendosur lejimin e kandidatit në fjalë dhe ia ka komunikuar këtë vendim atij në bazë të neneve 235-237 të ligjit 115 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Më tej, Këshilli për shkak të rënies së numrit të kandidatëve për ILD nën numrin 5 që parashikon detyrimi kushtetues, me vendimin nr.121, datë 09.09.2019 ka pezulluar procedurën për plotësimin e vendit vakant të ILD-së dhe shpalljen e procedurës së thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotëimin e këtij vendi, por nga ana tjetër në procedurë vlerësimi kanë qëndruar edhe kandidatët e tjerë të lejuar më parë ndër të cilit edhe zoti Artur Malaj.

Vendimi i lejimit ose ndalimit i parashikuar nga nenet 235, 236, 237 të Ligjit 115/2016, si një akt administrativ individual i nënshtrohet në rradhë të parë dispozitave të ligjit 115/2016 dhe vetëm në mënyrë plotësuese nga dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

Shumica i referohet pikërisht konceptit të shfuqizimit të një akti administrativ që përmban neni 113/1 i K.Pr.Administrative si pas të cilit : “Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj” dhe zbatimin e kësaj dispozite për shfuqizimin e vendimit të lejimit të z. Artur Malaj e bazon në një rrethanë faktike si edhe është vendimi i KPA-së për shkarkimin si magjistrat të kandidatit.

Koncepti i shfuqizimit edhe tekstualisht edhe ligjërisht lidhet me një veprim juridik ose fakt juridik si edhe është akti administrativ i cili është në fuqi dhe prodhon pasoja. Mirëpo vendimi i lejimit të kandidimit të z. Artur Malaj nr. 69, datë 24.07.2019, i ka prodhuar ose shterruar pasojat e tij, pra kandidati është lejuar për të vazhduar më tej me vlerësimin e aftësive të tij profesionale, integritetin moral dhe etik si dhe kriteret e tjera të parashikuar nga ligji. Pra, KED nuk ka se çfarë të shfuqizojë në këtë rast aq më shumë që ligji 115/2016 i ka të ndara dy fazat e procedurës së shqyrtimit të kandidatëve.

Akti në fjalë, pra i lejimit ka realizuar qëllimin e tij që është verifikimi i kushteve ligjore lejuese apo ndaluese dhe për rrjedhojë në bazë të nenit 104/4 gërma b të K.Pr.Administrative pasojat e tij kanë përfunduar.

Vendimi i KPA për shkarkimin e kandidatit është një fakt juridik që ka ndodhur pasi është përmbyllur faza verifikuese e kandidaturës. Nëse pranohet logjika juridike e shumicës dhe nëse merret parasysh situata hipotetike se kandidati do të ishte përzgjedhur nga Kuvendi si Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe vendimi i KPA-së për shkarkimin e tij do të ishte dhënë pas zgjedhjes së kandidatit, atëherë KED do të merrte vendim për shfuqizimin e vendimit të lejimit të kandidimit, vendimit të vlerësimit dhe renditjes së kandidatit dhe ndalimin e kandidimit të tij.

Në përfundim, nëse ecet në linjën e arsytimit të shumicës, duhet të mbahet parasysh edhe fakti se vendimi i lejimit të kandidimit në kohën e nxjerrjes së tij ka qenë i ligjshëm dhe në këto kushte shumica duhet të kishte parasysh edhe nenin 116 të K.Pr.Administrative sipas të cilit “1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, një akt administrativ i ligjshëm mund të shfuqizohet, vetëm nëse shfuqizimi është i domosdoshëm për të parandaluar apo eliminuar një dëm serioz të jetës dhe shëndetit të njerëzve apo sigurisë publike dhe kjo nuk mund të bëhet në mënyra tjera që cenojnë më pak të drejtat apo interesat e ligjshëm të fituar të palës.

2. Pala përfituese, në rast të shfuqizimit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, ka të drejtën e kompensimit nëse ka hyrë në marrëdhënie financiare nga të cilat nuk mund tërhiqet ose mund të tërhiqet vetëm duke pësuar dëme që nuk do të ishte e arsyeshme të kërkohen nga ajo.

3. Masa e kompensimit nuk duhet të tejkalojë interesin e arsyeshëm që ka pala në vazhdimin e sjelljes së pasojave juridike të aktit që shfuqizohet. Pala nuk përfiton kompensim për fitimin e munguar”.

Është e qartë se sa më sipër nuk mund të zbatohet për një kandidat që është shkarkuar si magjistrat nga KPA, prandaj zgjidhja më e drejtë juridike do të ishte vetëm ndërprerja e procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës së zotit Artur Malaj për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, rishpallur për plotësim me kandidatura të tjera në datën 09.09.2019.

Anëtarët në pakicë për pikat 2, 3 të vendimit nr. 142, datë 02.12.2019 të KED

Anëtarët

Vitore Tusha

Eriol Roshi

Eriol Roshi